ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: **A.K. - K.K.Gjilan**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP **Me nr. të prokurimit: 651-23-10479-2-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Mirëmbajtja Dimërore e Rrugëve në Gjilan**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

"Tali" Sh.p.k.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Shillovë - p.n.

(Adresa)

Gjilan

(Vendi) *(Kodi postar)* *60000*

044 500-645

(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Florim Zuka

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Talishpk17@hotmail.com

(Adresa elektronike)

08.01.2024

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

Shërbeni me përgjegjësi të kufizuara * GJILAN *

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

1. *Publikimi i Njoftimit për Kontratë në ueb faqe të E-prokurimit: 19.10.2023*
2. *Procedurë e hapur*
3. *Lloji i kontratës - Shërbime të ndryshme*
4. *Vlera e parashikuar: 390,000.00 €*
5. *Kriteri për dhënien e kontratës: Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët*
6. *Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 30.10.2023; Ora 14:00*
7. *Kerkesa per rishqyrtim - qe ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit ("TALI" Sh.p.k.) 18.10.2023*
8. *Vendimi nga AK mbi kërkesën për rishqyrtim - lidhur me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit 26.10.2023*
9. *Ankesa në OSHP - lidhur me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit 27.102023*
10. *Raporti i Ekspertit Shqyrtues – 13.11.2023*
11. *Vendimi i OSHP-së – 27.11.2023*
12. *Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara 29.11.2023*
13. *Kerkesa per rishqyrtim - qe ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit ("ALBA-PROJECT" Sh.p.k.) 01.12.2023*
14. *Vendimi nga AK mbi kërkesën për rishqyrtim - lidhur me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit 06.12.2023*
15. *Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 11.12.2023; Ora 14:00*
16. *Procesverbali i Hapjes së Tenderit 11.12.2023*
17. *Njoftimi i AK dhe Letrat Standarde 22.12.2023*
18. *Kërkesë për rishqyrtim – që ka të bëjë me njoftimin për dhënie të kontratës 27.12.2023*
19. *Vendimi nga AK mbi kërkesën për rishqyrtim - lidhur me njoftimin për dhënie të kontratës 29.12.2023*
20. *Ankesa në OSHP e parashtruar nga OE "TALI" SH.P.K. 08.01.2024*

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	☐			**Jo**	☒

Kemi pranuar procesverbalin e hapjes së tenderit përmes platformës së e-prokurimit me datë: 11.12.2023

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	X			**Jo**	

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

"OE: "Tali" Sh.p.k. në cilësi të palës së interesuar që ka interes juridik material lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Mirëmbajtja dimërore e Rrugëve në Gjilan** vlerëson se Autoriteti Kontraktues, ka vepruar në shkelje të parimeve bazike dhe parimeve kryesore, duke shkelur dispozitat qenësore të LPP-së si në vijim:

1) **Neni 7 të Ligjit Nr.04/L-042, Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi;**
2) **Neni 10 të Ligjit Nr.04/L-042, Mjetet për promovimin e transparencës;**
3) **Neni 11 të Ligjit Nr.04/L-042, Informatat Sekrete Afariste;**
4) **Neni 59 të Ligjit Nr.04/L-042, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;**
5) **Neni 69 të Ligjit Nr.04/L-042, Aftësia Teknike dhe/ose profesionale**
6) **Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve,**
7) **Neni 4 i RRUOPP-së – Paragrafi 4.1 dhe 4.4**
8) **Neni 7 i RRUOPP-së – Paragrafi 3**
9) **Neni 7 i RREGULLORES Nr.001/2022 Për Prokurimin Publik-Paragrafi 3,4**
10) **Neni 97.1 C i RREGULLORES Nr.001/2022 Për Prokurimin Publik**
11) **Ligjit nr 06/L081, për qasje në Dokumente Publike**

** *Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pretendimet ankimore 1

"OE: "TALI" Sh.p.k. në cilësi të palës së interesuar që ka interes juridik material, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe në konfor të dispozitave të Nenit 108/A të LPP-së me datën 22.12.2023, menjëherë pas pranimit të njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues ka paraqitur kërkesën për qasje në dokumentacionin e OE të rekomanduar për Dhënie të Kontratës "EL-BAU" Sh.p.k., në kuptim të nenit 10 dhe 11-të të LPP-së, por përkundër konfirmimit për qasje me datën 26.12.2023 neve nuk na është lejuar as shikimi, as fotokopjimi e as marrja me USB e dokumenteve me arsyetimin se oferta si tërësi është deklaruar si sekret afarist.

Këtu kemi të bëjmë me shkelje esenciale të ligjit për prokurim publik. Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligje tjera.

Neni 10 dhe 11, i LPP-së, përkatësisht neni 7 i rregullores për prokurim publik, qartë e trajton qeshtjen e dokumentacionit afarist.

Së pari te Aneksi 3 në Dosjen e Tenderit – KËRKESË PËR KONFIDENCIALITET - tek Deklarata mbi natyrën e dëmit material - pjesa e arsyetimit të klasifikimit të ofertës si sekret afarsit nga OE i rekomanduar për Dhënie të Kontratës nuk është dhënë deklaratë e qartë mbi natyrën e dëmit material dhe arsyet pse duhet të konsiderohen si sekret afarist.

Pastaj që nga momenti i mosofrimit të qasjes në dokumente nga ana e AK ne dyshojmë se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës është i papërgjegjshëm sidomos lidhur me kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional apo aftësinë teknike dhe profesionale.

Moslejimi dhe neglizhimi i qasjes në dokumente zyrtare sipas kërkesës me shkrim të parashtruar nga pala e interesuar kur një qasje e tillë e kërkuar është në përputhje me nenin 10 dhe 11 të Ligjit të Prokurimit Publik përbën shkelje të ligjit të prokurimit dhe zbehje të promovimit të mjeteve të transparencës.

> Ligjërisht sekret afarist mund të konsiderohen vetëm të dhënat personale, në kuptim të paragrafit 4, te nenit 11, të LPP-së, AK është dashur ta përgatitë versionin e "pastruar" të dokumenteve, ndaj OE-ve të cilat i kanë deklaruar ofertat e tyre si të tilla. Pra, me mos ofrim të qasjes në dokumenete AK nuk iu është përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji.

Gjithashtu për mohimin e qasjes në dokumente publike OSHP ka nxjerrë shumë vendime ku është gjykuar shumë më ndryshe nga AK.

Nuk e kuptojmë arsyen e mosofrimit të dokumenteve të cilat janë publike dhe në këtë rast nuk përmbajnë Informata personale, e të cilat janë:

Kontratat dhe Referencat janë dokumente të lëshuara nga institucionet publike dhe detyrë e secilit AK ti publikoj.

Paramasa dhe parallogaria është dokument i cili gjithmonë bëhet publike për arsye të transparencës, llogaridhënies dhe shfrytëzimit sa më mirë të parasë publike;

Te Aftësia Teknike dhe/ose profesionale: Psh. Diplomat e stafit profesional janë dokumente të lëshuara nga institucionet publike.

Te Aftësia Teknike dhe/ose profesionale: DUD per makinerite janë dokumente të lëshuara nga institucionet publike.

Nuk mund të konsiderohet sekret afarist:

*Një listë e nënshkruar dhe e vulosur e kontratave dhe referencave

*Një listë e nënshkruar dhe e vulosur me emrat dhe mbiemrat e stafit profesional apo teknik

*Diploma apo Cv e një inxhinieri

*Paramasa dhe Parallogaria nuk mund të konsiderohet si sekret afarist, si e tillë ajo mund të ketë ndërhyrje, mund të ketë gabime aritmetikore apo edhe pozicione me çmime jonormalisht të ulëta të cilën AK-K.K.Gjilan nuk ka lejuar që ta krahasojmë dhe të krijojmë pretendime konkrete ankimore bazuar sipas ligjit.

Ku këtu lindë pyetja dhe dyshimi se pse një AK në këto dokumente nuk lejon qasje!!!

Pretendimet ankimore 2

Menjëherë pas marrjes së vendimit të AK për shpalljen e fituesit me daten 22.12.2023 ne kemi kërkuar qasje në dokumentet me theks të veçantë ndaj OE fitues por edhe të OE i cili ka qenë më i liri por i papërgjegjshëm.

Me datën 26.12.2023 na është bërë konfirmimi nga AK-K.K.Gjilan që ne mund të marrim pjesë në qasje por përkundër konfirmimit për qasje neve nuk na është lejuar as shikimi, as fotokopjimi e as marrja me USB absolutisht e asnjë dokumenti me arsyetimin se oferta si tërësi është deklaruar si sekret afarist. Ku të vetmet dokumente të cilat na është lejuar ti shohim janë ato të Aneksit 3 - në Dosjen e Tenderit – KËRKESË PËR KONFIDENCIALITET edhe pse insisitmi ynë ka qenë që të mund të shohim ose të na jepet versioni i "pastruar" i dokumenteve.

Ne si palë e pakënaqur në këtë rast menjëherë kemi bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë:27.12.2023 lidhur me vendimin e AK-së për shpalljen e fituesit dhe kufizimit të tejskajshëm në qasje.

E vërteta qëndron ndryshe jo ashtu siç përshkruhet në vendimin e AK-së të Kërkesës për Rishqyrtim (të datës: 29.12.2023) se na është lejuar qasje e plotë në informatat dhe dokumentet e qasshme ku polemikat kanë filluar pikërisht në momentin kur ne kemi insistuar që së paku të shohim: Listën e kontratave dhe Listën e mjeteve, por çuditërisht për arsye të paqarta në këtë rast Autoriteti Kontraktues këto dokumente i ka dërguar me email vetëm pas 3 ditëve nga qasja pra, pas Kërkesës tonë për Rishqyrtim dhe Vendimit të tyre lidhur me këtë kërkesë, më saktësisht me datën: 29.12.2023 Ora: 11:29.

Lëre që nuk është ofruar qasje ashtu siç e lejon ligji por nuk na është ofruar fare as edhe një dokument tjetër pos Aneksit 3.
Nëse ne këto dokumente (edhe pse jo të mjaftueshme që të bëhet një vlerësim më objektiv i dëshmive) ti kishim marrë apo parë me kohë në ditën kur ne kemi shkuar në qasje atëherë AK nuk kish pasur nevojë me i dërgu pas 3 dite ashtu siç ka vepruar përmes emailit zyrtar.

Gjithashtu nuk qëndron pohimi nga AK se insistimi ynë ka qenë që të na ofrohet qasje në dokumentet që lidhen me pasqyrat ekonomike dhe financiare, kontratat e punës apo qasje të pakufizuar në të gjithë dokumentacionin e OE "EL-BAU" SH.P.K.

Me datën 29.12.2023 AK-K.K.Gjilan në orën 11:15 ka publikuar vendimin ku ka refuzuar si të pabazuar Kërkesën tonë për Rishqyrtim ndërsa në orën 11:29 na kanë dërguar email-in ku kanë bashkëngjitur:

*Vendimin mbi Kërkesën për Rishqyrtim;

*Aneksin 7 – Pajisjet dhe mekanizmi i obligueshëm + Listën e mjeteve teknike (të plotësuara, vulosura dhe nënshkruara nga "EL-BAU" SH.P.K.);

*Aneksin 6-të – Lista e Kontratave të realizuara në 3 vitet e fundit (të plotësuara, vulosura dhe nënshkruara nga "EL-BAU" SH.P.K.); si dhe

*Aneksin 3 – të OE: "EL-BAU" SH.P.K. dhe "AVAG GROUP" SH.P.K.

Ku këto dokumente të dërguara nga AK-K.K.Gjilan si: Aneksi 3, Aneksi 6, Aneksi 7 + Lista e mjeteve teknike (të plotësuara, vulosura dhe nënshkruara nga "EL-BAU" SH.P.K. kanë qenë të skanuara si kopje e jo nga origjinali ashtu siç janë kërkuar në Dosje të Tenderit.

Kërkesa 4	**Dëshmia 4**
Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas Aneksi 7	**Lista e mjeteve duhet të dorëzohet e skanuar nga origjinali - e nënshkruar dhe vulosur nga O.E. Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit, ndërsa pajisjet tjera, OE duhet ti dëshmojë me një dokument për pronësinë e tyre (faturë, DUD etj).**

Nëse këto dokumente janë kështu të skanuara si kopje e jo nga origjinali dhe janë pjesë e dokumentacionit të tenderit të OE "EL-BAU" SH.P.K. atëherë ky OE duhet të shpallet i papërgjegjshëm dhe lënda duhet të kthehet në rivlerësim.

Provë nga data 29.12.2023:

From: **Prokurimi Gjilan** <prokurimigjilan@rks-gov.net>
Date: Fri, Dec 29, 2023 at 11:29 AM
Subject: Njoftim
To: talishpk17@gmail.com <talishpk17@gmail.com>
Cc: Kujtim Bajrami <kujtim.bajrami@rks-gov.net>

I nderuar,

Sa I përket aktivitetit të Prokurimit me titull " **Mirembajtja e Dimerore e rrugeve ne Gjilan**" Nr.Prokurimit: **Gl 651-23-10479-2-1-1**.

Gjeni në attach Vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim së bashku me dëshmitë e bashkangjitura.

Faleminderit për mirëkuptim.

deshmit sipas shtojqes se ve... 4 MB | Vendim mbi Kerkesen per R... 2 MB | 20240105090232.pdf 165 KB

3 attachments (9 MB) Save all to OneDrive Download all

Provë nga data: 29.12.2023 të dërguara me email nga prokurimigjilan@rks-gov.net

E edituar ("e prerë" nga ne për arsye konfidencialiteti, bashkangjesim pjesën vetëm aty ku duket pjesa e nënshkrimit dhe vulës e Aneksit 6-të nga "EL-BAU" sh.p.k.) për t'i vërtetuar OSHP-së që këto dokumente janë dërguar tek ne të skenuara si kopje e jo nga origjinali.

Titulli I Aktivitetit : Mirëmbajtja dimërore e Rrugëve në Gjilan numëri i prokurimit : 651-23-10479-2-1-1

Nënshkrimi i Operatorit Ekonomik _____

Vula _____

Titulli I Aktivitetit : Mirëmbajtja dimërore e Rrugëve në Gjilan numëri i prokurimit : 651-23-10479-2-1-1

Aneksin nr. 7 - PAJISJET DHE MEKANIZMI I OBLIGUESHËM

(Ky Aneks është obligativ qe te plotësohet dhe ti bashkëngjiten e kerkuara ne FTD)
Vërejtje: Mbetet përgjegjësi e OE-së, që ti siguroj dhe përdorë të gjitha makineritë dhe paisjet e nevojshme për kryerjen e punëve në cilësi, sasi dhe kohën e kontraktuar duke përfshi makineri dhe paisje që nuk janë **ëketë listë.

Nr.	Lloji i mekanizmit dhe pajisjeve	Sasia e kërkuar (cope)	Sasia që ofron ofertuesi
1	Kamion special per pastrimin e rrugëve nga bora dhe hedhjen e kripes mbi 10 ton	3	3
2	Mini Kamion special per pastrimin e rrugëve nga bora dhe hedhjen e kripes për rrugë te ngushta max 5 ton me pesh bartëse	2	2
3	Traktor mbi 2 ton për pastrimin e rrugëve dhe hedhjen e krypes.	1	1
4	Traktor per pastrimin e trotuareve dhe hedhjen e krypës max 2 ton	1	1
6	Ngarkues-Eskavator per pastrimin e trotuareve	1	1
7	Kamion me frezë, për hedhjen – largimin e borës prej rruge.	1	1
8	Bulduzer	1	1
9	Grejder	1	1
10	Shkip	1	1
11	Kamion special me paisje mulqer per kositjen e brezit te rrugeve	1	1

Nënshkrimi i Operatorit Ekonomik _____

Vula _____

Titulli I Aktivitetit : Mirëmbajtja dimërore e Rrugëve në Gjilan numëri i prokurimit : 651-23-10479-2-1-1

Aneksi 3. KËRKESË PËR KONFIDENCIALITET

Nga KUVENDI KOMUNAL- GJILAN

(më tej "Autoriteti Kontraktues")

DUKE PASUR PARASYSH SE *(EL-BAU SH.P.K)* (më tej "Operatori Ekonomik"), duke përmbushur kërkesat e dosjes së tendertit për Nr. e Prokurimit të siptë-përmendur, Paragrafi 8 dhe 9 të Informacionit për Tenderuesit, ka dërguar informacionet sekrete afariste, si me vijim:

> *Identifikimi i informacioneve sekrete afariste dhe referimi në pjesët e dokumentave të dërguara:* Informacionet të cilat kërkojnë të mbrohen dhe klasifikohen nga AK si informacione sekrete afariste për të gjitha palët duke përjashtuar rastet sipas detyrës zyrtare por KRPP, OSHP dhe gjykatat kompetente, janë si më poshtë: a) *informacionet në lidhje me pozicionet ekonomike dhe financiare, sipas nenit 68 të LPP-së*; dhe b) *informacionet në lidhje me mundësitë teknike dhe/ose profesionale, sipas nenit 69 të LPP-së*.

DHE DUKE PATUR PARASYSH SE informacet e përmendura janë deklaruar që (i) nuk janë pronë publike, dhe (ii) janë të mbrojtura nga zbulimi i qëllimshëm ose nga pakujdesia nga ana e operatorit ekonomik ;

DHE DUKE PATUR PARASYSH SE qasja publike në informacionet e përmendura do të rezultonte me dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit ekonomik për arsyet vijuese:

> *Deklarata mbi natyrën e dëmit të dëmit material dhe arsyet pse do të duhej të shfaqet.* Kërkesa lidhur me kufizimin e qasjes në informatat dhe dokumentet si informacione sekrete afariste që përfshihen në nenin 68 dhe 69 të LPP-së ka për qëllim të mbrojtjes së konfidencialitetit komercial siç janë sekretet e biznesit, sekretari profesionale dhe të politikës ekonomike të kompanisë. Kjo për faktin se informacionet dhe dokumentet në fjalë nuk kanë të bëjnë me dokumente publike dhe nga ana tjetër qasja, vënia e tyre në dispozicion (zbulimi i qëllimshëm apo nga pakujdesia) nga palët tjera përfshirë edhe OE konkurrent me përjashtimet e parashikuara sipas nenit 7.3 të rregullores do të mund të na shkaktonin dëme materiale dhe jomateriale të interesave komerciale legjitime të afarizmit të kompanisë tonë. Prandaj kërkojmë nga AK që në përputhje me nenin 11 të LPP-së si dhe nenin 7 të Rregullorës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik që njësitë e deklaruara si sekret afarist t'i klasifikojë dhe mbrojë si sekret afarist ashtu që mos t'i vënë në dispozicion të OE dhe palëve tjera por t'i largojë nga materiali në të cilën palët e interesuara kanë të drejtë qasje sipas paragrafit 3 të nenit 10 të LPP-së.

PRANDAJ, unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar Operatorin Ekonomik, nëpërmjet kësaj shprehi dëshirën që Autoriteti Kontraktues t'i klasifikojë dhe mirëmbajë informacionet e përmendura si informacione sekrete afariste.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik	
Emri i Kompanisë	EL BAU SH.P.K
Adresa e plotë:	LIMON STANICI GJILAN
I përfaqësuar nga:	
Emri	FATLUM PIREVA
Pozita	DREJTOR
Nënshkrimi	
Data	11.12.2023
Vula	

Titulli I Aktivitetit : Mirëmbajtja dimërore e Rrugëve në Gjilan numëri i prokurimit : 651-23-10479-2-1-1

Aneksi 3. KËRKESË PËR KONFIDENCIALITET

Për: **KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**

(më tej "Autoriteti Kontraktues")

DUKE PASUR PARASYSH SE *[AVAG GROUP SH.P.K]* (më tej "Operatori Ekonomik"), duke përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit për Nr. e Prokurimit të sipër-përmendur, Paragrafi 8 dhe 9 të Informacionit për Tenderues, ka dërguar informacionet sekrete afariste, si më vijon

Identifikimi i informacioneve sekrete afariste dhe referimi në gjetjet e dokumenteve të dërguara: Informacionet të cilat kërkojmë të trajtohen dhe klasifikohen nga AK si informacione sekrete afariste për të gjitha palët duke përjashtuar rastet sipas detyrës zyrtare per KRPP, OSHP dhe njësitat kompetente, janë si më poshtë: a) *informacionet në lidhje me pozicionet ekonomike dhe financiare, sipas nenit 68 të LPP-së;* dhe b) *informacionet në lidhje me mundësitë teknike dhe/ose profesionale, sipas nenit 69 të LPP-së.*

DHE DUKE PATUR PARASYSH SE informatat e përmendura janë deklaruar që (i) nuk janë pronë publike, dhe (ii) janë të mbrojtura nga zbulimi i qëllimshëm ose nga pakujdesia nga ana e operatorit ekonomik .

DHE DUKE PATUR PARASYSH SE qasja publike në informacionet e përmendura do të rezultonte me dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit ekonomik për arsyet vijuese:

Deklarimi mbi mënyrën e dëmit të dëshmuar material dhe arsyet pse do të duhej të shfaqet: Kërkesa lidhur me kufizimin e qasjes në informatat dhe dokumentet si informacion sekret afarist që përfshihen me nenin 68 dhe 69 të LPP-së ka për qëllim të mbrojtjes së konfidencialitetit komercial siç janë sekretet e biznesit, sekretet profesionale dhe të politikës ekonomike të kompanisë. Kjo për faktin se informacionet dhe dokumentet në fjalë nuk kanë të bëjnë me dokumente publike dhe nga ana tjetër qasja, vënja e tyre në dispozicion (zbulimi i qëllimshëm apo nga pakujdesia) nga palët tjera përfshirë edhe OE konkurrent me përjashtimet e parashikuara sipas nenit 7.3 të rregulloreës do të mund të na shkatërrojë dëme materiale dhe jomateriale të interesave komerciale legjitime të afarizmit të kompanisë tonë. Prandaj kërkojmë nga AK që në përputhje me nenin 11 të LPP-së si dhe nenin 7 të Rregulloreës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik që njësitë e deklaruara si sekret afarist t'i klasifikojë dhe mbrojë si sekret afarist ashtu që mos t'i vënë në dispozicion të OE dhe palëve tjera por t'i largojë nga materiali në të cilën palët e interesuara kanë të drejtë qasje sipas paragrafit 3 të nenit 10 të LPP-së.

PRANDAJ, unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar Operatorin Ekonomik, shprehim kërkojë shprehi dëshirën që Autoriteti Kontraktues t'i klasifikojë dhe mbrojë informacionet e përmendura si informacione sekrete afariste.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik	
Emri i Kompanisë	AVAG GROUP SH.P.K
Adresa e plotë:	PRISHTINË
I përfaqësuar nga:	
Emri	MUHAMET ALIU
Pozita	DREJTOR
Nënshkrimi	
Datë	11.12.2023
Vula	

Përmendje e historisë procedurale të këtij aktiviteti të prokurimit

Pa harruar të përmendim faktin se qysh në fillim të këtij aktiviteti të prokurimit - te njoftimi për kontratë përkatësisht në kërkesat e FDT-së Autoriteti Kontraktues ka pasur tendenca që mos ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese.

Autoriteti kontraktues me kërkesat që i ka paraqitur tek aftësitë teknike përkatësisht te lista e pajisjeve dhe mekanizimi i obligueshëm – Aneksi nr. 7 në një mënyrë ka tentuar që të eliminoj konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik duke futur kërkesa të panevojshme dhe jo relevante duke diskriminuar në dëm te disa OE-ve, ka kërkuar pajisje që nuk janë të nevojshme per këtë aktivitet të prokurimit, ku edhe pas Kërkesës për Rishqyrtim lidhur me njoftimin e kontrates ose me dokumentet e tenderit AK-K.K.Gjilan me arsyetime dhe argumente te pajustifikueshme duke cituar se është bërë gabim teknik në përshkrimin e pajisjes nga "Kamion për tërheqjen e ujërave fekale/zhbllokimin e kanalizimeve" në "Kamion për pastrimin e ujmbledhësave" nuk përfillë kërkesën tonë për të korrigjuar kërkesën e tyre të panevojshme vepron duke kthyer vendimin si të pabazuar dhe duke lënë në fuqi të gjitha kërkesat e Aneksit nr.7, por fatmirësisht vetëm nëpërmjet OSHP-së kërkesat e panevojshme u reduktuan.

Prandaj ne si OE pjesmarrës duke përcjellë të gjitha ndodhitë lidhur me këtë aktivitet të prokurimit ku nuk kemi qenë të vetmit ku kemi bërë Kërkesë për Rishyrtim kemi pasë dyshimet tona që një OE po favorizohet. Ku këto dyshime vazhduan të forcohen duke u bazuar në ngjarjet e mëvonshme të cilat i kemi paraqitur në këtë ankesë.

Shkaqet e shkeljeve te - Neni 7, të Ligjit Nr.04/L-042, Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese

Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

Në këtë rast AK duke përdorur metoda të ndryshme, me lajthitje duke i ikur përgjegjësisë të cilën e bartin, që të sjellen duke ndjekur parimin e transparencës, duke mos iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji, duke ua mundësuar e lehtësuar punën OE të caktuar e në anën tjetër OE-ve të tjerë duke ua vështirësuar punën, bëjnë që të ulet interesimi dhe zbehet vullneti në mënyrë që të heçin dorë nga ky aktivitet i prokurimit dhe jo vetëm. Nga kjo krijohet monopol me OE të caktuara gjë që ndikon në uljen e konkurencës.

Shkaqet e shkeljeve te - Neni 10, të Ligjit Nr.04/L-042, Mjetet për promovimin e transparencës

AK – K.K.Gjilan në këtë rast ka shkelur **Nenin 10 të Ligjit Nr.4/L-042, Mjetet për promovimin e transparencës** duke mos e dhënë as edhe një dokument të vetëm me arsyetimin se oferta si tërësi është deklaruar si sekret afarist. Ku nuk është marr as mundi më i vogël që të bëhet klasifikimi apo "pastrimi" i dokumenteve nga ato publike me ato sekrete afarsite.

Paragrafi 3 i këtij neni citon:

Me kërkesë me shkrim nga cilado palë e interesit, autoriteti kontraktues i sguron qasje të arsyeshme palës që kërkon të ketë qasje përveç informatave sekrete afariste **TË CILAT VËRTETOHEN SI TË TILLA.**
Ne si palë e ineteresuar për këtë aktivietet të prokurimit nuk na është lejuar as kontrollimi, as fotokopje e dokumenteve e as marrja me Usb, as edhe një dokumenti të vetëm përveç Aneksit 3 dhe shtrohet pyetja ku është transparenca në këtë rast, pse nuk është bërë klasifikimi dhe "pastrimi" i dokumenteve dhe të na jepet një version i dokumenteve të klasifikuara në mënyrë që të dëshmohet se ky OE është i përgjegjshëm.

Shkaqet e shkeljeve te - Neni 11, të Ligjit Nr.04/L-042, Informatat Sekrete Afariste

AK – K.K.Gjilan në këtë rast ka shkelur **Nenin 11 të Ligjit Nr.4/L-042, Informatat Sekrete Afariste**

Paragrafi 4 i këtij neni citon:

Autoriteti kontraktues që e ka klasifikuar një element të informatës si informatë sekrete afariste sipas paragrafit 3. të këtij neni, **do të përgatitë versionin e "pastruar" të çdo dokumenti**, nëse elementi i tillë gjendet në dokumentin në të cilin po ashtu gjendet informacioni që nuk konsiderohet të jetë sekret. **Versioni i tillë i pastruar duhet të përfshihet në materialin në të cilin ka qasje publiku dhe palët e interesuara sipas nenit paragrafit 3. të nenit 10 të këtij ligji.** Autoriteti kontraktues do të bashkëngjisë në ballinë të versionit të tillë të pastruar një njoftim që thotë se (i) autoriteti kontraktues i ka klasifikuar disa elemente të caktuara të informatës në dokumentin origjinal si informata sekrete afariste, me kërkesën e operatorit përkatës ekonomik, dhe (ii) versioni i pastruar i bashkangjitur është përgatitur nga autoriteti kontraktues dhe është një kopje e saktë e origjinalit pas heqjes ose fshirjes së informatave të tilla sekrete afariste.

Shkaqet e shkeljeve te - Neni 59, të Ligjit Nr.04/L-042, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëv

Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit por në këtë rast lindin dyshime që ky tender nga OE i rekomanduar për kontratë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit pikërisht në faktin që edhe pse kemi tentuar, kemi kërkuar, ne nuk kemi parë asnjë lloj dokumenti të vetëm që do të vërtetonte se kjo ofertë është e përgjegjshme.

Për këtë arsye e vetmja rrugë që na ka mbetur ne si palë e dëmtuar është duke iu drejtuar OSHP-së.

Shkaqet e shkeljeve te - Neni 69 të Ligjit Nr.04/L-042, Pika 1

Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës edhe në këtë rast lindin dyshime që OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka plotësuar në përputhshmëri të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit pikërisht në faktin që edhe pse kemi tentuar, kemi kërkuar, ne nuk kemi parë asnjë lloj dokumenti të vetëm që do të vërtetonte që ky OE është i përgjegjshëm.

Shkaqet e shkeljeve te – Neni 7 i RRUOPP-së – Paragrafi 3

Pas përfundimit të aktivitetit të prokurimit **vetëm informatat e klasifikuara, nga OE** dhe **të pranuara nga AK, si sekrete të biznesit do të mbesin sekrete** për të gjitha palët duke përjashtuar KRPP, OSHP, përfshirë ekspertin shqyrtues dhe panelin shqyrtues dhe gjykatat kompetente.

Pra, qartë thuhet **vetëm informatat e klasifikuara nga OE dhe të pranuara nga AK si sekrete do të mbesin sekrete, jo domosdoshmërisht i gjithë dokumentacioni i tenderit siç është bërë në këtë rast**. Pra, AK nga joprofesionalizmi, neglizhimi apo për qëllime të caktuara ka bërë shkelje esenciale të ligjit për prokurim publik, konkretisht në mjetet per promovimin e transparencës.

Shkaqet e shkeljeve te Neni 97.1 C i RREGULLORES Nr.001/2022 Për Prokurimin Publik

Neni 97.1 – C **i RREGULLORES Nr.001/2022 Për Prokurimin Publik**

Shkelje të rënda i cilëson:

Mos lejimi dhe/ose neglizhimi i qasjes në dokumente zyrtare sipas kërkesës me shkrim të parashtruar nga pala e interesit kur një qasje e tillë e kërkuar është në përputhje me nenin 10 dhe 11 të ligjit të Prokurimit Publik.

Shkaqet e shkeljeve te Ligjit nr 06/L081, Ligji për qasje në Dokumente Publike

Qasja në dokumente publike është e garantuar edhe me ligjin nr. 06/L081, për Qasje në Dokumente Publike.

Ky ligj garanton të drejtën e secilit person, pa diskriminim mbi çfardo baze, për të pasur qasje në dokumentet publike, të prodhuara, pranuara, mbajtura apo kontrolluara nga institucionet publike. E drejta për qasje në dokumente publike e secilit person, si dhe garantimi dhe përmbushja e kësaj të drejte nga ana e institucioneve publike përbën një prej themeleve të institucioneve demokratike dhe transparente janë vetëm disa nga frazat e cituara ne nenet e këtij ligji e që në rastin tonë e forcojnë bindjen që AK-K.K.GJILAN anashkalon dhe zbehë mjetet per promovimin e transparencës.

Duke u bazuar në faktet e lartshënuara konsiderojmë se AK ka vepruar në kundërshtim të plotë me dispozitat e LPP-së dhe akteve nënligjore duke bërë diskrimin të qartë ndërmjet OE.

Ky aktivitet i prokurimit duhet të kthehet në rivlerësim dhe të na jepet qasje meritore në mënyrë që të bëhet një vlerësim më objektiv i dëshmive.

Andaj kërkojmë nga OSHP, që të bëhet një VLERËSM REAL i këtij aktiviteti të prokurimit dhe të merrni:

VENDIM

Të APROVOHET si e bazuar ankesa e OE "TALI" Sh.p.k.

Të ANULOHET vendimi mbi Dhënien e Kontratës OE "EL-BAU" Sh.p.k. dhe lënda të kthehet në RI-VLERËSIM.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Kompensim i dëmeve materiale për shpenzimet procedurale, kompensim i fitimit të humbur nga kjo punë që do të kërkohet në vazhdim.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe*
- *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*